Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno Më/Dana 11-05-2010 vjet.

| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
|---|---|---|---|

01-013/1474

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 pika c), nenit 40.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës " Gazeta Zyrtare nr 28/08" nenit 5.1 pika c) dhe nenit 22 të Statutit të Komunës o2. nr. 013/5165 të datës 18.11.2008, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2010 aprovon këtë:

# VENDIM

PËR NDARJEN E LOKACIONIT PËR NGRITJEN E MONUMENTIT TË KERIM LEWTON GAZETAR I "ASOSIETED PRESS" I VRARË GJATË KONFLIKTIT 2001 NË MAQEDONI

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë NDAN lokacionin për vendosjen – ngritjen e një monumenti për gazetarin e "Asosieted Press" Kerim Lewton i vrarë gjatë konfliktit në Maqedoni në vitin 2001, në parcelën nr 2634-2, vendi i quajtur "fshati për varrin e babait" ("selo babin grob") në sipërfaqe prej 36m$^2$ Zona kadastrave Viti, pasuri shoqërore "rrugët" në pronësi të Komunës së Vitisë.

Neni 2.

Bartja e të drejtës së shfrytëzimit nga neni 1 i këtij vendimi bëhet pa kurrfarë kompensimi, bazuar në kërkesën e Klubit të gazetarëve " Kerim Lewton" e datës 01.04.2010.

Neni 3

Mjetet financiare për ngritjen e këtij monumenti do të sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë, Klubi i Gazetarëve "Kerim Lewton" në Viti, dhe donator të ndryshëm.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 5.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:
1. Klubit të gazetarëve " Kerim Lewton" në Viti
2. Arkivit

KUVENDI KOMUNËS SË VITISË
KRYETARI
Skenderbe Hebibi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
KUVENDI KOMUNËS - SKUPŠTINA OPŠTINE